

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA NË VITI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë kontestimore e shkallës së parë, sipas gjyqtarit Nexhat Aliu me sekretaren juridike Azize Rama, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit F. P. nga fsh.P., të cilin e përfaqëson vllau L. A..u, nga fshati P., kundër të paditurit V.. Il. (S..ave) nga fsh.P., tani me adresë të panjohur, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm E.S.. avokat në Viti, baza e kontestit vërtetim i pronësisë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, me datë 06.09.2016, shpall këtë;

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET kërkesëpadia e paditësit F. P. nga fsh.P..Komuna e Vitisë, dhe **i njihet** e drejta e pronësisë në ngastrat kadastrale nr.xxxx, në vendin e quajtur “S K.. P.” ne siperfaqe prej xxxxm2 ZK.xxxxx, ngastra kadastrale nr.xxxxx ne vendin e qujtur “S. I. K.” ne siperfaqe prej xxx m2. ZK Pozheran, të regjistruara në emër të paditurit V.. I. (S.), **në bazë të shitblerjes.**

DETYROHET i padituri V.I . (S.), tani me adresë të panjohur, t’ia njohë të drejtën e pronësisë paditësit F. P.. dhe të durojë që ngastrat e lartpërmendura t’i regjistroj në emrin e paditësit.

Ky aktgjykim për Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi të Komunës së Viti, paraqet bazë, që në regjistrat kadastralë, të bëhet ndryshimi.

II.Shpenzimet e procedurës do t’i heq paditësi.

A r s y e t i m

Gjykata të paditurit V. I. (S), i kishte dërguar përgjigje në padi, por përgjigjja ishte kthyer, sepse i paditur ishte e pamundur t’i gjindet adresa e vendbanimit apo vendqëndrimit, ne fletëkethese thuhej se i padituri ishte i panjohur.

Në seancën përgatitore më datë XXXX, përfaqësuesi i paditësit F.P. vllau L. A.., ka mbetur në tërsi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke i propozuar gjykates qe te paditurit V. I., t’i caktohet një përfaqësues i përkohshëm, ku gjykata kishte vendosur duke caktuar përfaqësuesin e përkohshëm për të paditurit av. E. S. nga Vitia.

Në seancë e dt.XXXX, përfaqësusi i paditësit kishte propozuar caktimin e një eksperti të gjeodezisë dhe s’bashku me të gjykata të del në vendin e ngjarjes për të identifikuar dhe përkufizuar ngastrat kontestuese. Ai më tej kishte shtuar se këto ngastra I kishte blerë nga V. I. bleri Sh. Sh. që ja kishte paguar qmimin e shitblerjës që nga viti XXX ja kishte shitur I. P., e në vitin XXXX I.P. ja kishte shitur F. P.ia kishte paguar çmimin e kontraktuar dhe kishte hy në posedim të panderprerë.

Në vendin e ngjarjes në fshatin Pozheran, me dt...XXX, gjykata kishte konstatuar se paditësi F.. P..i shfrytëzon ngastrat me kultur oborr ku dhe ka të ndertuar shtëpi.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit av. E. S. nuk e kishte kundërshtuar identifikimin dhe përkufizimin që kishte bërë eksperti gjeodet për ngastrat në fjalë, por e kishte kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit, duke rezervuar të drejtën për deklaram në seancën kryesore.

Në seancën kryesore të datës XXXX, përfaqësuesi i paditësit kishte mbetur pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke theksuar se ngastrat kontestuese paditësi i ka blerë dhe i shfrytëzuar pa u penguar nga askushë dhe i kishte paguar çmimin e kontraktuar dhe kishte hyrë në posedim të pa penguar nga askush. Po ashtu, përfaqësuesi i paditësit F. P. vllau L. A. kishte propozuar të dëgjohen dëshmitarët Sh. Sh.dhe N.P.që të dy nga fsh.....FF.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit av. E. S. , nuk e kishte kundërshtuar propozimin e paditësit për ndëgjimin e dëshmitarëve.

Dëshmitari Sh. Sh. kishte deklaruar: Eshtë e vertetë se ngastrat kontestuese babai im Sh.. Sh.. i ka blerë keto dy ngastra nga I.Vl., në vitin XXXX dhe i ka paguar në tersi ku në atë kohë kemi hyrë në posedim dhe shfrytëzim pa u penguar nga askush, askushë nuk është ankuar që mos t'ju kemi dhenë të hollat. Në atë kohë nuk ka guxuar të hynë në pronen e serbit e mosë të ja jepë të hollat. Kur diku në vitin XXXX apo XXX, familja jonë keto ngastra ja ka shitur babait të N.. H. P..dhe vllaut të N. I. P. ku neve nai ka paguar në tersi çmimin e kontraktuar për dy ngastrat. Sa më kujtohet shitblerja është bërë me marka Gj...

Këtë dëshmitar e kishte pyetur përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit, i cili l'u kishte përgjigjur pyetjeve i njëjti nuk e kundërshton deklaramen të dëshmitarit.

Edhe dëshmitari N.P.kishte deklaruar : Eshtë e vertetë se vllau im I.. P.. keto ngastra i ka blerë nga Sh.. Sh...dhe i ka paguar në tërësi çmimin e kontraktuar. Pas blerjes vllau im I.. ka hyrë në shfrytëzim dhe posedim, vllau im I...keto ngastra i ka blerë diku në vitin XXXXXXX, nga se ka kaluar një kohë dhe nuk më kujtohet sakt, shitblerja është bërë me valut Gj. nga se në atë kohë pate filluar të përdoret edhe Marka për shitblerjen.Vllau im ishte interesuar që të kontakton me serbin me qëllim për të bërë bartjen por nuk ka mundur të kontaktoj nga se kishin shkuar në serbi.

Gjykata kishte lexuar dhe shtjelluar këto prova, çertifikatën e pronës për ngastrat kontestuese nr. UL.XXX , e datës XXX dhe kopja e planit e dt. XXXX, kontrata private mbi shitblerjen e lidhur me dt.XXX Lexohet përgjegjja nga AKP e datës XXX, referenca në stacionin policor në Pozheran e datës 10.06.2016, ekspertizën e kryer nga eksperti i gjeodezisë F. Sh., e datës XXX, për ngastrat nr.XXX0, 01040-0 ZK.PXXX.

Në fjalën përfundimtare të përfaqësuesi paditësit L.. A... deklaron, në provat në shkresat e lëndës, shiqimit të drejtëpërdrejt të ngastrës nga ana e gjykates dhe ekspertit të gjeodezisë në vendin e ngjarjes si dhe deklaramen të dy dëshmitarëve të sotëm gjykata konsideroj se duhet të bindet se ngastrat kadastrale nr.XXXX,dhe XXXX ZK.XXXX e ka blerë duke i paguar çmimin dhe ka hyrë në posedim në të njëjtën që prej para Luftes, andaj i propozoi gjykatës që të njihet e drejta në pronësinë në keto ngasta kadastrale.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit, av.Edison Simani deklaron, e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesën padinë lidhur me ngastrën kontestuese nga arsyeja nga se nuk kanë ofruar prova materjale-ndonjë kontratë nuk e ka kundërshtuar ekspertizën e ekspertit F..Sh...dhe ka kërkuar nga gjykata që t'i shtjellon të gjitha provat lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridiko-civile.

Gjykata duke u bazuar ne nenin 8, të LPK-së, vlerësoi provat veç e veç dhe si tërësi..

- Me leximin e çertifikatës së pronës, e dates XXXX me ngastrat kontestuese nr.XXX dhe XXX në emër të pronarit V. I. nga fsh.P.....gjykata vërtetoi se padia përputhet plotësisht në subjektet si palë kontestuese.

-Eksperiza e ekspertit të gjeodezisë F. S..., tregon përputhshmërinë e kërkesëpadisë në aspektin formal me gjendjen faktike në teren, si dhe gjendjen aktuale mbi shfrytëzimin e këtyre ngastrave kadastrale.

-Deklaratat e dëshmitarve Sh. Sh. edhe N. P.. të dhëna në seancën e fundit të shqyrtimit gjyqësor, e forcojnë kërkesën e paditësit në njëërën anë dhe besimin e gjykatës për ekzistimin e punës juridike.

Gjykata ka vërtetuar se në mes paditësit F.. P., dhe të padituri V.I., S. Sh.. dhe I.P.. kishte egzistuar raporti juridik, i cili edhe pse jo i lidhur në formën e shkruar, ai ka prodhuar efekt juridik, me faktin se paditësi ka hy në posedim në të njëjten palujtshmëri, të cilën edhe e mbanë më tej pa u penguar nga askush.

Gjykata për tërë këtë raport juridik mes palëve ndërgjyqëse u shërbye me të drejtën materiale e cila ishte në fuqi gjatë krijimit të këtyre raportëve, siç është neni 28, i LMD-së, sepse vullneti i palëve ka fuqi detyrimi dhe është mbi ligjin.

Andaj, gjykata duke u bazuar në gjitha këto prova dhe fakte të pakontestueshme, duke qenë e pavarur në vendosje miratoi kërkesëpadinë e paditësit.

Shpenzimet e procedurës do t'i bartë paditësi F. P., neni 453, i LPK-së.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË VITI

C.nr.402/2012

Më. 06.09.2016

Sek. Juridike
Azize Rama

Gj y q t a r i,
Nexhat Aliu

UDHËZIMI PËR MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.